



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 340 Prot.

Tiranë, më 04 .03. 2019

V E N D I M

Nr. 29, Datë 04. 03. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 137 rregj., datë 12.09.2018, e J. H. kundër Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, në të cilën pretendohet për diskriminim “*për shkak të etnisë¹*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se është prind i një fëmije të moshës 3 vjeç, shtetases XH. H. Në muajin Qershor 2018, ka kërkuar të rregjistrojë fëmijën në kopësht, por nuk ka mundur për shkak të tarifës së përcaktuar nga ana e Bashkisë Tiranë. Ky detyrim mujor, sipas tij, është i papërballueshëm për shkak të kushteve ekonomike në të cilat ndodhet. Sipas ankuesit, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 40, datë 29.03.2018 “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës*”, janë përcaktuar disa kategori të familjeve, ku fëmijët e tyre përfitojnë pa pagesë shërbimin në kopësht.

Ndonëse janë përcaktuar disa kategori që përfitojnë falas, disa të tjera janë lënë jashtë kësaj liste dhe nuk mund të klasifikohen në asnjërën prej tyre. Një prej këtyre rasteve është edhe familja e ankuesit. Familja e tij, pa ndihmë ekonomike, nuk arrin të përfitojë rregjistrimin falas të fëmijës në kopësht, pasi nuk bën pjesë në asnjë prej kategorive përfituese.

¹ Referuar Vërtetimit të lëshuar nga organizata jo-fitimprurëse T'REJA, më datë 27.09.2018, ankuesi i përket komunitetit egjiptian.

Në përfundim të ankesës, J. H. sqaron se lënia jashtë e grupeve përfituese të shërbimit pa pagesë në kopshte dhe çerdhe të familjeve që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike, por që nuk kanë asnjë burim tjetër të sigurtë e të qëndrueshëm të ardhurash mujore e ka vënë në kushte të një diskriminimi të tërthortë për shkak të etnisë nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë², gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit Nr. 10 221/2010, fillimisht ankesa nuk plotësonte elementët e kërkuar nga ky ligj dhe për këtë arsye me shkresën Nr. 1241/1 prot., datë 17.09.2018 KMD i kërkoi ankuesit plotësimin e saj.

Me plotësimin e elementëve të ankesës më datë 27.09.2018 dhe në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1241/2 prot., datë 09.10.2018, kërkoi informacion lidhur me pretendimet e ankuesit nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Këshillit Bashkiak Tiranë.

² Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

³ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, nuk vunë në dispozicion informacionin e kërkuar.

2. Duke qënë se Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, nuk vuri në dispozicion informacionin lidhur me kërkesat e shkresës Nr. 1241/2 prot., datë 09.10.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Për këtë me anë të shkresës Nr. 1552 prot., datë 05.11.2018, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 12.11.2018, ora 12⁰⁰ dhe kërkoi të vihet në dispozicion informacion dhe prova lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Sipas njoftimit të realizuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Tiranë nuk u paraqit asnjë përfaqësues, ndërsa pala ankuese u përfaqësua⁴ nga shtetaset A. S. dhe N. B.

Megjithatë, në përgjigje të shkresës Nr. 1552 prot., datë 05.11.2018, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve⁵ Tiranë (në vijim QEZHEF) dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, me anë të shkresave⁶ respektive, informuan KMD-në se, në vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 40, datë 29.03.2018 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”*, ka pasur ndryshime dhe shtesa përsa i përket kategorive që përfitojnë shërbim pa pagesë në çerdhe dhe në kopshte. QEZHEF si institucioni që zbaton këtë vendim, si dhe nisur nga përvoja e hasur gjatë viteve ka sugjeruar këto ndryshime me arsyetimin se: *“Çerdhet dhe kopshtet publike si institucione sociale së pari, duhet të ofrojnë mundësi për shtresat në nevojë. Bazuar dhe në përvojën e deri tanishme, lidhur me kategoritë që përfitojnë reduktimin mujor të tarifës së ushqimit në çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë, ka konstatuar nevojën e disa ndryshimeve lidhur me këto kategori. Për shkak të ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike të familjeve dhe individëve në nevojë, por edhe për arsye se është vërejtur që ka kategori të familjeve dhe individëve në nevojë që nuk janë përfshirë në reduktimin mujor të tarifës ushqimore, propozuam disa ndryshime dhe shtesa të kategorive që duhet të përfitojnë reduktimin e tarifës mujore për ushqim”*. Në vijim të arsyetimit Bashkia Tiranë ka sqaruar se sipas tyre në asnjë moment ky propozim i QEZHEF, nuk ka të bëjë me diskriminim etnik dhe është në mbështetje të parashikimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Sipas QEZHEF, nëse situata e familjes së ankuesit do të ishte pranë ose nën nivelin jetik, atëherë ato duhet të jenë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike pa asnjë dyshim dhe sipas përcaktimeve ligjore, si rrjedhojë do të përfitonte shërbimin e çerdhes dhe të kopshtit

⁴ Me anë të deklaratës së përfaqësimit datë 07.11.2018

⁵ Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, është një njësi ekonomike administrative e mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve në varësi të Bashkisë së Tiranës e krijuar në Prill të vitit 2004 me vendim të Këshillit Bashkiak, Nr.14, datë 10.03.2004, si rrjedhojë e bashkimit të Qendrës Ekonomike të Arsimit me Drejtorinë e Çerdheve. *Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve*, më poshtë e quajtur *QEZHEF*-ve është institucion vendor, person juridik, publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës.

⁶ QEZHEF me anë të shkresës Nr. 1415/1 prot., datë 09.11.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1589 prot, datë 12.11.2018 dhe Këshilli Bashkiak Tiranë me anë të shkresës Nr. 41486/1 prot., datë 21.11.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1552/1 prot, datë 22.11.2018.

pa pagesë. Gjithashtu, QEZHEF në përfundim ka sqaruar se: “...kategoritë aktuale të miratuara me VKB-në Nr. 40, datë 29.03.2018, janë konceptuar gjithëpërfshirëse si në rrafshin social-ekonomik, ashtu edhe në atë të statusit civil, ndryshe nga kategoritë që ishin përcaktuar përpara këtij vendimi. Aktualisht është rritur gama e kategorive si dhe numri i përfituesve të familjeve në nevojë. Për sezonin 2018-2019, QEZHEF ka rregjistruar një numër të lartë të fëmijëve që i përkasin etnisë rome dhe egjiptiane, kjo falë dhe bashkëpunimit me Njësitë Administrative, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, si dhe organizata të ndryshme që në thelb kanë punën me komunitetin rom dhe egjiptian”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar rezulton se, gjatë vitit 2018-2019, subjekti ankues është paraqitur pranë Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit, për të rregjistruar fëmijën në kopësht, por për shkak të situatës ekonomiko-finaciare mjaft të vështirë dhe faktit që nuk trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk mund të përfshihet në asnjërin nga kategoritë e listuara në VKB Nr. 40 dhe si rrjedhojë nuk mund të rregjistrojë fëmijën në kopësht.

Referuar provave të administruara gjatë procedurave hetimore rezulton se, përmes surgjerimit nga ana e QEZHEF, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, është vendosur përcaktimi i disa kategorive që përfitojnë pa pagesë shërbimin në çerdhe dhe kopësht për fëmijët e tyre, ku ndër to janë:

1. Fëmijët me statusin e jetimit;
2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit;
3. Fëmijë me aftësi të kufizuara;
4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara;
5. Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës;
6. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Referuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak (në vijim VKB), fëmijët që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, përfitojnë pa pagesë rregjistrimin në kopshte dhe në çerdhet e administruara nga QEZHEF. Ndonëse janë përcaktuar disa kategori që përfitojnë falas këtë shërbim, në VKB-në e miratuar, fëmijët që vijnë nga familje që i përkasin komunitetit rom apo

egjiptian nuk trajtohen si një kategori e veçantë përfituesish. Në interpretim të informacionit të dhënë nga ana e QEZHEF dhe Këshillit Bashkiak Tiranë, familjet që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, nuk shihen si kategori e veçantë në këtë VKB, por bëjnë pjesë dhe përfshihen në kategorinë e përfituesve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike.

Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, gjatë vitit 2018-2019, në kopshtet nën administrimin e QEZHEF dhe Bashkisë Tiranë, janë regjistruar fëmijë që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian. Një fakt të tillë nuk është kundërshtuar nga ana e palës ankuese.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, arsimimit dhe edukimit të fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë apo nga komuniteti rom/egjiptian etj.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e fëmijës”*.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.
- *“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës”*, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 7531/1991, datë 11 Dhjetor 1991, i ofron mbrojtje fëmijëve, duke shprehur në mënyrë të qartë të drejtën për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë të fëmijëve. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë fëmijëve të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.
- *“Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial”*, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 7768, datë 09 Nëntor 1993, synon që shtetet palë dënojnë diskriminimin racial dhe zotohen të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të zhdukjes së çdo forme të diskriminimit racial, të ndihmojnë mirëkuptimin midis të gjitha racave, dhe të realizojnë angazhimet e marra përsipër sipas Konventës. Në nenin 5 të saj, ndër të tjera Konventa parashikon se, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e të drejtës për arsim.

Vazhdimisht në legjislacionin shqiptar janë parashikuar mekanizma për të stimuluar arsimimin dhe edukimit, nëpërmjet lehtësirave për fëmijët që vijnë nga komuniteti rom/egjiptian.

Në këtë kuadër, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015, vjen si një dokument i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare. Ai është tërësisht i mbështetur, jo vetëm në parimet bazë të Kushtetutës së

Shqipërisë por edhe në parimet themelore të antidiskriminimit të të gjitha Konventave Ndërkombëtare. Ky Plan, përfshin politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Arsimimi i komunitetit rom dhe egjiptian, kanë qënë pjesë e pesë prioritetëve kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnin, “*masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese*”⁷. Përbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyesin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: rregjistrimi civil , aksesimi në drejtësi, arsimi, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Arsimimi i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në arsimin parashkollor janë pjesë integrale e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, njësitë e qeverisjes vendore duhet të krijojnë mundësinë për integrim e komuniteteve romë dhe egjiptiane, në krijimin e rrethanave dhe mundësive që fëmijët e këtyre komuniteteve të frekuentojnë ciklin parashkollor. Ata duhet t’u japin përparësi familjeve të varfra e familjeve që i përkasin komuniteteve të veçanta, për të cilat përfitimi i shërbimeve arsimore nuk është shumë i lehtë.

Gjithashtu, Bashkia Tiranë në vitin 2017, ka hartuar Planin për Zhvillimin e Komunitetit Lokal Rom dhe Egjiptian 2017-2020, si një instrument planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuar edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social dhe ekonomik të dy komuniteteve në Bashkinë e Tiranës. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të dy komuniteteve.⁸

Nga një analizë të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 dhe Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2017-

⁷ Bashkimi Evropian, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

⁸ Marrë nga Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, i Bashkisë Tiranë

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

2020, evidentohet se një ndër konstatimet e bëra në këto dokumenta është niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane, është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. Varfëria dhe kushtet e jetesës ndikojnë drejtpërdrejt në mundësitë e fëmijëve romë dhe egjiptianë për t'u arsimuar.⁹ Gjithashtu, në këto dokumenta të hartuara theksohet fakti që sipas të dhënave evidentohet se regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.¹⁰

Në kapitullin III, të Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Tiranë, si një ndër qëllimet strategjike dhe objektivat sipas fushave prioritare janë: *“Rritja e numrit të fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin të gjithë nivelet e arsimimit (parashkollor, arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë); Hartimi i Planit të Veprimit për Bashkinë e Tiranës “Çdo fëmijë Rom dhe Egjiptian në kopësht” me qëllim evidentimin, regjistrimin dhe frekuentimin e arsimit parashkollor nga fëmijët romë dhe egjiptianë; Heqja e tarifave të kopshtit dhe çerdhes për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane...”*¹¹

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vitin 2014, ka miratuar Udhëzimin Nr. 21, datë 08.08.2014, ku në Kreun I, pika 2, ka vendosur që: *“Drejtuesit e kopshteve dhe drejtuesit e shkollave që kanë në varësi kopshte: a) Të regjistrojnë me përparësi fëmijët romë në kopshte, sidomos në zonat e banuara nga popullsia rome. Në rastet kur kopshti nuk ka kapacitet për të përmbushur nevojat e bashkësisë përreth tij, t'u jepet përparësi fëmijëve të komunitetit rom. b) Të bashkëpunojnë me njësitë bazë të qeverisjes vendore për të mundësuar që fëmijët romë të përjashtohen nga pagesa e depozitës së garancisë në Tiranë dhe nga pagesat e boreve të prindërve romë në të gjithë vendin...”*

Këtë frymë ka përcjellë edhe Komisionerja për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, znj. Dunja Mijatović, në raportin e publikuar më datë 13.09.2018, ku në pikën 42 të tij, citon se: *“Pavarësisht nga masat pozitive të marra nga autoritetet shqiptare, mungesa e përfshirja e fëmijëve romë në arsimin e zakonshëm mbetet një çështje shqetësuese. Komisioneri¹² është veçanërisht i shqetësuar për nivelin e raportuar të ulët të regjistrimit të romëve fëmijët në arsimin parashkollor, për shkak të varfërisë, mungesës së regjistrimit, diskriminimit ose mungesës e ndërgjegjësimit të prindërve romë për përfitimet e arsimit parashkollor.”*

Gjithashtu, në paragrafin I dhe II, të faqes 2, të Raportit të sipërcituar, znj. Mijatović shprehet se: *“...komisioneri është i shqetësuar për mungesën e përfshirjes së disa fëmijëve shqiptarë, në veçanti fëmijëve romë dhe fëmijëve me fëmijë aftësi të kufizuara, në arsimin e zakonshëm. Komisioneri u bën thirrje autoriteteve që të mbështesin përpjekjet që synojnë përfshirjen e fëmijëve romë në arsimin e zakonshëm, duke punuar ngushtë me komunitetin e prindërve romë*

⁹ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 28

¹⁰ Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, fq. 18

¹¹ Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, Matrica 2.5.2., faqja 50.

¹² I referohet znj. Mijatović

dhe duke rritur përpjekjet për të trajtuar mungesën e përfshirjes së romëve në arsimin parashkollor...”.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, është evidentuar se: *“Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulëta të regjistrimit në shkollë, alfabetizimit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%.¹³”*

Në këto kushte dhe referuar informacionit të sipërcituar, konstatohet se integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian, është një ndër qëllimet strategjike dhe objektivat e Republikës së Shqipërisë.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, Komisioneri vëren se nga ana e Bashkisë Tiranë dhe QEZHEF, është menduar duke propozuar që familjet e komunitetit rom dhe egjiptian të përfshihen në pikën 6 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 40, datë 29.03.2018 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”*, ku citohet se *përfitojnë pa pagesë shërbimin në çerdhe dhe kopësht për fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike*, por nuk është menduar se ky grup vulnerabël të jetë pjesë e VKB-së, si kategori më vete përfituese.

Në rastin konkret, janë parashikuar si kategori të veçanta: Fëmijët me statusin e jetimit; Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit; Fëmijë me aftësi të kufizuara; Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara; Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës, ndërsa fëmijët e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë përcaktuar si kategori më vete.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, në nenin 11, Veprime pozitive, parashikon: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”*

Si dhe në nenin¹⁴ 6, pika 1 të tij, parashikon se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.”*

GJEDNJ-ja ka theksuar se "e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara në KEDNJ po ashtu është shkelur kur shtetet ... nuk i trajtojnë ndryshe personat

¹³ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 20, paragrafi i fundit.

¹⁴ Neni 6, Trajtimi i ndryshëm i përligjur

*situata e të cilave janë dukshëm të ndryshme.*¹⁵ Në mënyrë të ngjashme, direktivat e BE-së për mos-diskriminim parashikojnë shprehimisht mundësinë e veprimit pozitiv, ku thuhet: "Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk do të pengojë asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose të miratojë masa specifike për të parandaluar ose të kompensojë disavantazhet e lidhura me (një shkak të mbrojtur"¹⁶).

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet më tej nga udhëzimet e lëshuara nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të të drejtave të njeriut të OKB-së. Këto organe kanë theksuar që masat e tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, dhe jo të shtrihen në kohë apo hapësirë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar pabarazinë në fjalë.¹⁷ Sipas Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në mënyrë që të jenë të lejueshme këto masa duhet të kenë si qëllim vetëm eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe parandalimin e disbalancave të ardhshme.¹⁸ Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave thekson se '*masa speciale të përkohshme*' mund të përfshijnë "*trajtim preferencial; rekrutimin, punësimin dhe promovimin; qëllimet numerike të lidhura me kornizat kohore; dhe sistemet e kuotave*".¹⁹

Gjykatat kanë tentuar të trajtojnë diskriminimin në këtë kontekst jo si një formë e veçantë e diskriminimit në vetvete, por si një përjashtim nga ndalimi i diskriminimit. Me fjalë të tjera, gjykatat pranojnë se ka ndodhur trajtimi i ndryshëm, por që mund të justifikohet në interes të korrigjimit të një disavantazh të mëparshëm, siç është nën-përfaqësimi në vendin e punës të grupeve të veçanta.²⁰

Mbështetur në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, rekomandimet e dhëna nga përfaqësues të partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe referuar të dhënave të grumbulluara, në të cilat është konstatuar niveli i ulët i arsimimit dhe se regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, Republika e Shqipërisë ka hartuar një sërë politikash në funksion të integritimit të komunitetit rom dhe egjiptian, ndër të cilat është edhe arsimi falas për anëtarët e këtyre komuniteteve, për t'i krijuar shanse të barabarta në shoqërinë shqiptare. Rregjistrimi i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në kopësht, krijon baza për zhvillimin e hershëm të këtyre fëmijëve, duke i krijuar akses në sistemin arsimor, si bazë e rëndësishme për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

¹⁵ ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44. Similarly, ECtHR, *Pretty v. UK* (No. 2346/02), 29 April 2002, para. 88.

¹⁶ Racial Equality Directive, Article 5; Employment Equality Directive, Article 7; Gender Goods and Services Directive, Article 6; and also with a slightly different formulation: Gender Equality Directive (Recast), Article 3.

¹⁷ Handbook on European non-discrimination law fq.38

¹⁸ UN Committee on the Elimination of Racial Discrimination, 'General Recommendation No. 32: The Meaning and Scope of Special Measures in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination' UN Doc. CERD/C/GC/32, 24 September 2009, paras. 21-26.

¹⁹ UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 'General Recommendation No. 25: Article 4, para. 1 of the Convention (temporary special measures)' UN Doc. A/59/38 (supp), 18 March 2004, para. 22.

²⁰ Handbook on European non-discrimination law fq.38

Në çështjen *Ponomaryovi v. Bullgarisë* (Nr. 5335/05), 21 qershor 2011, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka cituar ndër të tjera se: “...arsimimi është një e drejtë që gëzon mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjithashtu arsimi është një lloj tejet i veçantë i shërbimeve publike, që jo vetëm u sjell përfitime atyre që e përdornin atë, por që ka, po ashtu, edhe një funksion më të gjerë shoqëror dhe ishte i pazëvendësueshëm për të çuar më tej të drejtat e njeriut.

Në vlerësim të KMD-s, fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me grupet e tjera si fëmijët me statusin e jetimit, ato me aftësi të kufizuara apo grupet e tjera që përfitojnë nga VKB Nr. 40, datë 29.03.2018, edhe pse Bashkia Tiranë ka marrë përsipër angazhime sa i takon kësaj kategorie.

Justifikimi i Bashkisë se fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian do të beheshin përfitues nga kriteri nr 6. i VKB-së Nr. 40, datë 29.03.2018 “Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike”, nuk qëndron për vetë faktin se ky kriter lidhet vetëm me gjendjen ekonomike të përfituesve, ndërkohë ky komunitet ka problematika më të gjëra të cilat bëhen pengesë për integrimin e tyre në shoqëri. Vetë angazhimet e shtetit Shqiptar për këto problematika janë tregues i qartë i ekzistencës së tyre. Gjithashtu ankesat e ardhura në adresë të KMD-së janë një provë e qartë e këtij përjashtimi.

Sa më sipër KMD vlerëson se, fakti që kategori të tjera përfituesish janë bërë pjesë e VKB-së Nr. 40, datë 29.03.2018, si kategori të veçanta dhe kategoria e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, nuk është parashikuar si një kategori përfituese, ka vënë këta të fundit në kushte të pabarabarta me kategoritë e tjera përfituese, si dhe nuk është hartuar bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin²¹ 2 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një

²¹ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, për shkak të etnisë, shkak i cili është parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë trajtimit të ankesës së J. H., u administruan prova dhe argumenta se ankuesi disponon shkakun e mbrojtur të etnisë²².

“Etnia” është shkak, për të cilin Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të mbrojtura nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”²³, për të cilat ankuesi pretendon diskriminim dhe trajtimit të pafavorshëm të tij.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë:

- Në ndryshim nga kategoritë e tjera përfituese, nga VKB Nr. 40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të cilat janë parashikuar në mënyrë nominale, kategoria e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, nuk është parashikuar.

²² Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racia është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

²³ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

- *Pavarësisht politikave të hartuara nga shteti shqiptar dhe nga vetë Bashkia Tiranë, kjo e fundit ka dështuar në krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian.*

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 7, parashikon se: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në Fushën e të Mirave dhe të Shërbimeve, në nenin 20, pika 1/b, ka sanksionuar se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: ...b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.” Në vijim pika 2/ç, parashikon se: “Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor; ...”

Në nenin 11, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka parashikuar se: “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”

Referuar Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjisllacionit të brendshëm²⁴ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, KMD sjell në vëmendje se e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë²⁵, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: “.....kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme.....”.

²⁴ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

²⁵ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

Përsa më lart, KMD vlerëson se Bashkia Tiranë ka diskriminuar shtetasen XH. H. duke dështuar të krijojë përjashtim nga rregulli për fëmijët rom dhe egjiptian edhe pse është në dijeni të situates aktuale të këtyre komuniteteve si dhe është angazhuar për integrimin e këtyre komuniteteve bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, duke mos përfshirë si kategori të veçantë rregjistrimin në kopësht të fëmijëve të komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe miratimi i VKB-së Nr. 40, datë 29.03.2018, duke pretenduar se këto familje duhet të përfitojnë nga pika 6 e vendimit, i ka trajtuar të gjitha familjet njëllor pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të etnisë²⁶, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së arsimit të fëmijëve të familjeve të komunitetit rom dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të etnisë, të shtetasës XH. H., nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, Bashkia Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, si kategori që përfiton rregjistrimin në kopshte pa pagesë.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Bashkia Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

²⁶ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia)

(Fusha: Arsim)